



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**

**Komiteti për Komunitete**

**Nr. 02-060/01-0005604-1/24 dt. 31.01.2024**

**Mitrovicë**

**PROCESVERBAL**

**Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Komunitete**  
**Seanca e 24-të**

**Koha:** 31.01.2024 ora 15:00  
**Vendi:** Salla e Mediave  
**Të pranishëm:** Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani  
Anëtarët e Komitetit për Komunitete: Xhafer Preteni, Majlinda Kurti, Elidiana Budini Haziri, Xhevrije Bahtiri Ademi, Gazmend Asllani, Ardita Aliu, Agron Jashari dhe Esat Krasniqi

**Mungoi:** Habib Hajdini

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Komitetit i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se në zbatim të nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 61, paragrafi 2, dhe nenit 62, të Statutit të Komunës; nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores për punën e Kuvendit; nenit 14, paragrafi 3, të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit; për sot kam thirrur mbledhjen e rregullt të Komitetit për Komunitete me këtë:

**REND DITE:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Raporti i punës së ZKKK-së për vitin 2023

***Rendi i ditës u miratua unanimisht***

**Pika 1**  
**Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimitisht.**

**Pika 2**

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani sa i përket Raportit të punës së ZKKK-së për vitin 2023 fjalën për ta sqaruar ia kaloi znj. Snezhana Nestorovic.

Snezhana Nestorovic në pika të shkurta e arsyetoi Raportin e punës së ZKK-së për vitin 2023.

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani kërkoi që të përmirësohet fjalia "Lagja e Romëve" dhe të shenohet Lagja "Adem Voca". Pastaj Vizitat në kuadër "Shko Shiqo" dhe "Shko - informohu" e shoh çdo herë në raportet që ju na i sjellni andaj më intereson se a është aktive dhe kur ka qenë aktive në bazë të raportit që na e keni sjell më intereson se a është aktivitet më i gjatë, dhe a e ka pasur vizita edhe në vitin 2023 nëse jo pse figuron në raport.

Bedri Sadiku: Sa i përket fjalës "Lagja e Romëve" vetëm është bërë ndonjë gabim mirëpo do ta përmirësojmë. Prej vitit 2008 unë jam i punësuar dhe e punoj këtë punë dhe që atëherë dhe deri në vitin 2015 ajo çdo herë ka qenë aktiv po ashtu ka pasur edhe grup punues, pra grupi punues komunal ka qenë i përbërë dhe çdo vit nga dy herë në vit kemi pasur vizita, ndërsa në vitin 2023 nuk ka pasur por në raport figuron sepse ka ekzistuar çdo vitë por mundemi ta heqim.

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani: Pasaj vizitat që i bëni në lagje unë mendoj që janë shumë të pakëta nga na juaj, mendoj që më shumë duhet të dilni në teren për vizita për shkak të komunikimit që mund ta keni më të lehtë. Po ashtu ju si zyre më intereson se çka jeni duke bërë për të drejtat e komuniteteve dhe çka bëni për ti mbrojtur nga diskriminimi.

Bedri Sadiku: Në kuadër të drejtorisë çdo pyetje që na ofron ne mund të përgjigjemi, por në kuadër të drejtave nuk jam kompetent për këtë çështje, për këtë çështje është z. Enis Kacapor. Ju kisha lutur që z. Kacaporit ti drejtoheni.

Snezhana Nestorovic: Po ne si drejtori nëse kemi ndonjë kërkesë në atë drejtim ne shkojmë e verifikojmë rastin dhe e paraqesim rastin tek organet kompetente.


Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani: Unë po kërkoi nga ju që të na jepni më shumë sqarime dhe po pres që keni më shumë afërsi me komunitetet dhe të shihni sa po respektohen të drejtat e tyre.

Anëtarët e Komiteti për Komunitete unanimitisht e miratuan Raporti i punës së ZKKK-së për vitin 2023.

**Mbledhja përfundoi punimet në ora 16:00 min.**

**Mitrovicë**  
**31.01.2024**

**Procesmbajtës:**  
  
**Afërdita MAXHUNI**

**Kryesuesi i Komitetit**  
  
**Jeton RRAHMANI**